

FJALA E DEPUTETIT BUJAR ÇELA

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qeveritarë dhe qytetarë,

Vetëm në saj të kësaj aleance, të kësaj maxhorance, të këtij binomi qytetarë-qeveritarë, bëhet i mundur realizimi i këtij projektbuxheti kaq të madh. Nuk dua të bie në përsëritje, sepse i kanë përmendur të gjithë kolegët, majtas dhe djathtas, por dua të përfitoj nga rasti për të diskutuar jo më shifra të ripërsëritura, me të cilat herë-herë edhe abuzohet. Kam bindjen se, ndryshe nga fjalët që foli bashkëqytetari im, që ka jetuar në Lushnjë, por unë vazhdoj të jetoj, që jeton në Tiranë, por është nga Tropoja, ky Kryeministër dhe kjo qeveri në dy mandate ka dëshmuar që gjithçka që e ka projektuar e ka realizuar në të gjitha fushat. Është fat dhe qytetarët tani e kanë të qartë si drita e diellit. Vetëm kjo maxhorancë, ky Kryeministër, dëgjon mirë, planifikon dhe realizon. Të gjitha të tjerat janë teori, fjalë parlamenti e kafeneje, të cilat na kanë ndarë thjesht në dy krahë, por ne kemi interesa të njëjta; ne dhe fëmijët tanë. Po ta shikojmë realitetin në sy, në të gjitha fushat e jetës në Shqipëri, nuk do të ishte e mundur, e përmend edhe bota, që dy gjëmat e mëdha, tërmeti dhe pandemi të tejkaloheshin pa këtë maxhorancë, të luftohej, dhe lufta vazhdon që këto të minimizohen dhe të shkojnë drejt zeros.

Pra, është kjo qeveri, janë këta drejtues, të cilët asnjëherë nuk e kanë ndarë fjalën nga veprat. Shifrat e buxhetit janë dy herë më shumë, për të mos thënë që është buxheti më i madh në kohën demokratike që jetojmë; një buxhet, i cili nuk ka lënë qelizë të vendit pa prekur, pa vënë dorën e tij, duke e filluar nga Tropoja e kushëririt tim, e parafolësit, dhe duke përfunduar deri në Sarandë. Ne nuk duhet të na verbojnë arritjet; nuk duhet t'i injorojmë ato, por duhet t'i përmendim, t'i japim shpresë dhe besim njëritjetrit, në mënyrë që dorë për dorë të bëjmë më të mirën, të realizojmë ëndrrën e shqiptarëve për ta çuar Shqipërinë në familjen e madhe europiane. Kam thënë një herë në këtë parlament, ju lutem, mos shani në gjuhë të huaj, sepse nuk u bën mirë fëmijëve tanë, të majtë apo të djathtë. Në kaq vjet kemi parë se shumë deputetë ikin nga familja e majtë dhe shkojnë në partinë e djathtë dhe e kundërta. Këto janë gjëra të jetuara. Unë dua të përmend shumë arritje, të cilat janë të dukshme e të prekshme nga të gjithë, që nga Tropoja, Rruga e Arbrit, Unaza e Tiranës, ndërhyrjet në spitale, në shëndetësi dhe në çdo qendër shëndetësore, në shkolla dhe në të gjitha dikasteret, në të gjitha postat e Shqipërisë. Po të hysh sot në postën e Lushnjës, është i qartë investimi shumë i madh që është bërë atje. Kjo nuk ndodh vetëm në Lushnjë, por është një pamje e ndryshuar në të gjitha strukturat që u shërbejnë qytetarëve, në të gjitha sportelet ka kulturë, ka një vend ku qytetarët ndihen shumë rehat dhe i marrin shërbimet në kohë rekord.

Unë e di se çfarë është bërë gjatë këtyre viteve, sepse jam bashkëqytetar, sepse jam ai që kam kontribuar sa kam mundur, por edhe kam marrë nga kontributet e qeverive të ndryshme. Pa përmendur politikën e madhe, dua të përmend politikën në qarkun e Fierit, e cila ka bërë shumë. Unë thjesht u drejtohem ministrave, jo tek e tek, por të gjithëve së bashku: vëmendje të shtuar për Lushnjën, sepse Lushnja është hambar i Shqipërisë dhe vazhdon të jetë, ashtu siç ka qenë! Shpesh

edhe protestat, edhe lufta politike bëhen në Lushnjë, pra sipas teorisë dhe thënies së popullit “Gjuhet pema që ka kokrra, nuk gjuhen plepat.” Thuhet “Organizohen greva dhe protesta nga fermerët dhe nga grumbulluesit.” Nuk është e vërtetë. Ka plot njerëz të manipuluar që kanë ardhur nga rrethet e tjera. Kolegu im nga Durrësi, Alban Xhelili, shpjegoi se si është përfitimi dhe ku shkon humbja. Askush nuk humbet. Të gjithë përfitojnë në këtë buxhet, por ka shumë kontabilistë, ata që i mbajnë letrat dhe kartat fermerit, që abuzojnë me kartat, marrin kartat, firmosin dhe bëjnë fatura fiktive që të përfitojnë po ata, jo fermeri. U bëj thirrjeve fermerëve lushnjarë të mos e ngatërrojnë hallin dhe djersën e tyre me gaztorët, por të vazhdojnë të punojnë, sepse qeveria e kësaj partie, kjo qeveri e mandatit të tretë, do të jetë edhe më afër tyre sesa ka qenë. Është vetëm viti i parë i mandatit të tretë, dhe unë i mirëkuptoj edhe ironinë, sepse nuk më shqetësojnë shumë. Populli ka thënë: “Qentë le të lehin, karvani të shkojë para” dhe karvani i socialistëve do të ecë përpara, sepse ne nuk shajmë, ne punojmë. Ne nuk flemë, por punojmë së bashku me ta. Rritja e pagës Qëndrimi pranë pensionistëve dhe njerëzve në nevojë, investimet e shumta mua më bëjnë shpresëplotë dhe shpreh votën pro këtij projektbuxheti, i cili do të jetë një buxhet i realizueshëm dhe do të vërë themele edhe më të forta dhe të pakthyeshme që vendi ynë të ecë drejt Europës së Bashkuar.

Unë dua të tërheq vëmendjen për investimet që janë bërë në Fier për sistemimin e lumit të Gjanicës, që është bërë një model, një shëtitore. Sikurse ish-kryetari i bashkisë bëri Lanën, ashtu po bëhet sot Fieri. Në qoftë se ka një fierak, një deputet opozite që vjen nga kjo zonë dhe nuk bën dot diferencën, kjo është për keqardhje. Unë u bëj thirrje ministrave që të shikojnë disa segmente rrugësh që lidhin dy rrethe, rruga Thanasaj-Sallbeg, e cila lidh Bashkinë e Lushnjës me Bashkinë e Peqinit, rruga Hysgjokaj-Rrasë, që lidh Bashkinë e Lushnjës me Bashkinë e Belshit dhe plot segmente të shkurtra që vlejnë shumë. Gjithashtu, u bëj thirrje që të shikojnë problemin e certifikatave të tokës; legalizimi po ecën, nuk janë vrarë njerëz në lidhje me legalizimin, por janë vrarë për çështjen e pronësisë. Nëse ka nevojë për një reformë edhe më të përkryer, edhe më të shpejtë, është çështja e pronësisë. I bëj thirrje qeverisë, në veçanti ministres së Infrastrukturës, me të cilën kam komunikuar dhe kemi gjetur mirëbesimin, se ka shumë mbikalime, por mbikalimi i Klubit të Shoferit është një nyje që lidh dy bashkitë, por jo vetëm, të rrethit të Lushnjës, Divjakë-Lushnjë, por lidh të gjithë zonën që vjen nga Berati për të shkuar në plazhin e Divjakës, lidh Jugun dhe kalimi jonormal, që nuk garanton jetën e qytetarëve, duhet bllokuar sa më shpejt. Mbikalimi duhet bërë. Nuk kushton shumë, por është emergjent. Nuk është si mbikalimet e tjera. Edhe një herë, shpreh bindjen se ky buxhet është më i miri dhe shpreh votën time pro.